



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

RAPORT

Mbi ecurinë e punës në IKP për vitin 2024

HYRJE

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ka ushtruar këto kompetenca kryesore:

- a. Ushtron ankim ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankim i cili shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 179/b/5 i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, neni F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 63/1 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim, për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP), në përmbushje të detyrimeve ligjore për transparencë dhe llogaridhënie, si dhe në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në Fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, ka hartuar Raportin mbi realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuar në planin vjetor të punës, për vitin 2024.


Ky raport përmban të dhëna të detajuara për veprimtarinë në tërësi të IKP-së gjatë vitit 2024, si dhe gjatë gjithë periudhës së funksionimit të institucionit, për vitet 2018-2024.

Qëllimi i këtij raporti është për të pasqyruar punën e kryer, detyrat e realizuara gjatë kësaj periudhe duke përmbyllur plotësisht shqyrtimin e të gjitha vendimeve të njoftuara nga KPK, i cili përkon me mbarimin e mandatit kushtetues të institucionit, më 31.12.2024, referuar nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024”

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Institucioni i Komisionerëve Publikë është drejtuar nga dy Komisionerë Publikë: z. Florian Ballhysa dhe znj. Irena Nino (11 maj 2022, data e emërimit të saj në detyrë), pas largimit të z. Darjel Sina dhe emërimit të tij në një detyrë tjetër. Komisionerët Publikë në ushtrimin e detyrës së tyre janë mbështetur nga: Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga 5¹ Këshilltarë ligjorë aktualë, nga 6 Këshilltarë sipas strukturës, dhe 4 Këshilltarë ekonomikë, Kancelari dhe Njësia Administrative, e përbërë nga 16 punonjës.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONERËVE PUBLIKË



Struktura organizative e Institucionit të Komisionerëve Publikë është miratuar me vendimin nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, të ndryshuar.

¹ Këshilltar ligjor, i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në vitin 2023.

Në kuadër të mbarimit të mandatit të IKP-së, Kuvendi ka miratuar Vendimin nr. 111/2024, “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë”, e cila do të vazhdojë aktivitetin për përmbylljen e dokumentacionit financiar dhe përpunimin e gjithë dokumentacionit arkivor të IKP-së, dhe dorëzimin e tij në institucionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

TRANSPARENCA & MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë”, si dhe kuadrin ligjor e nënligjor, lidhur me të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ka publikuar në faqen zyrtare: www.ikp.al, të gjithë veprimtarinë e institucionit; njoftimet për ushtrim ankimi, mosankimet, njoftimet e seancave gjyqësore, rekomandimet e ONM-së. Në “Programin e Transparencës”, i cili është i riformatuar sipas kërkesave të KPIMDHP, që në datën 30.3.2021, pasqyrohen të dhëna që lidhen me kuadrin ligjor e nënligjor, mekanizma kontrollues e monitorues, buxhetin dhe procedurat e prokurimit, statistika të procesit, regjistrin e kërkesave për informacion nga publiku apo palë të treta të interesuara etj.

Në të gjitha rastet e materialeve të publikuara, kryesisht ato të lidhura me çështjet në proces rivlerësimi, zbatohen rregullat e dispozitat në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me KPIMDHP, më 28 janar të vitit 2024, ashtu si edhe në 28 janar të vitit 2023, në faqen e internetit të institucionit për të sjellë në vëmendjen e gjithësecilit se sa të kujdesshëm duhet të jemi gjatë përdorimit të pajisjeve elektronike dhe teknologjisë, në kuadër të ruajtjes së informacionit dhe të dhënat personale, është publikuar/vendosur posteri elektronik ndërgjegjësues "28 JANAR – DITA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE"², në 3 forma: në "Home Pages", në formën e një "Alert Notice Box" (i cili shfaqet në momentin që hapet faqja), si dhe në formën e një postimi sipas linkut: <http://ikp.al/2023/01/27/28-janar-dita-e-mbrojtjes-se-te-dhenave-personale/>

² Më 26 prill 2006, Këshilli i Evropës vendosi të caktojë një Ditë të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, e cila festohet çdo vit në datë 28 Janar, datë e cila përkon me miratimin në vitin 1981 nga Këshilli i Evropës të Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”. Vendi ynë e ka përfshirë në legjislacionin kombëtar këtë dokument me miratimin e ligjit nr. 9288/2004. Konventa është modernizuar në maj të vitit 2018 (Konventa 108+) me aprovimin e Protokollit CETS No. 223, i cili u nënshkrua në 28 janar 2022 edhe nga Shqipëria.

Në këtë datë, qeveritë, parlamentet, organet kombëtare të mbrojtjes së të dhënave dhe aktorë të tjerë në nivel global, kryejnë aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

I. STATISTIKË E PROCESIT


I.1 STATISTIKË PËRMBLEDHËSE PËR VITET 2018-2024

I.1.1 - Tabelë përmbledhëse për vitet 2018-2024


Periudha	Vendime të njoftuara nga KPK	Dispozitivi i vendimit të njoftuar			Rekomandime nga ONM	Ankime	Mosankime	Ankime	
		Konfirmim në detyrë	Shkarkim nga detyra	Ndërprerje procesi				Me gjykim të përfunduar	Përgatitje për gjykim
Viti 2018	77	33	29	15	5	16	61	16	
Viti 2019	127	55	44	28	5	13	114	13	
Viti 2020	103	35	38	30	3	16	87	16	
Viti 2021	171	62	68	41	8	14	157	14	
Viti 2022	109	50	36	23	2	11	98	5	6
Viti 2023	126	76	28	22	12	29	97	15	14
Viti 2024	96	63	27	6	7	25	71	4	21
Totali	809³	374	270	165	42	124	685	83	41

³ Përfshin 4 vendime të ankimura nga IKP, të cilët u rishqyrtuan nga KPK, dhe pasi u rinjoftuan në IKP, u vendos mosankimi i tyre

I.1.2 - Vendime të njoftuara 2018-2024




Grafiku nr. 1 – Vendime të njoftuara: 2018-2024




Grafiku nr. 2 – Vendime të njoftuara në IKP sipas dispozitivit, 2018-2024

Vihet re, se viti 2021 ka numrin më të lartë të proceseve të ndërprera dhe shkarkimeve nga detyra.



I.1.3.-Rekomandime nga ONM, 2018-2024




Grafiku nr. 3 – Numri i rekomandimeve të ONM-së, sipas viteve: 2018-2024

Sipas grafikut nr. 3, vihet re se në vitin 2023 është numri më i lartë i rekomandimeve (12), krahasuar me vitet e tjera të ushtrimit të aktivitetit të institucionit.

Në të gjitha rastet e rekomandimeve të ardhura në IKP, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka ushtruar ankim kundër vendimeve të KPK-së.


Nëse bëjmë një ndarje të rekomandimeve të ONM-së sipas funksionit të subjekteve të rivlerësimit për të cilët është ushtruar rekomandimi rezulton se numri më i madh i përket prokurorëve (24) ndaj (18) të gjyqtarëve.



Grafiku nr. 4 – Numri i rekomandimeve të ONM-së, sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit: 2018-2024


Vendime të shqyrtuara-Ankime të ushtruara-Kërkimi i ankimit-Ankime sipas funksionit të subjekteve të rivlerësimit-Mosankime
Viti 2024

I.1.4-Shqyrtimi i vendimeve, rekomandimeve, denoncimeve nga publiku: 2018-2024





Grafiku nr. 5– Ankime të ushtruara nga shqyrtimi i vendimeve, konfirmimeve, rekomandimeve, në vitet 2018-2024

Në grafikun nr. 6 pasqyrohen të dhënat mbi vendimmarrjen e Komisionerëve Publikë në shqyrtimin e vendimeve të njoftuara nga KPK, në vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024.




Grafiku nr. 6 – Ankime dhe mosankime në vitet 2018-2024



Grafiku nr. 7 – Ankimet e kërkuara nga Komisionerët Publikë sipas dispozitivit të vendimit të KPK-së-viti 2024


KËRKIMI I ANKIMIT NË VITE- 2018- 2024



Grafiku nr. 8 – Ankimet e kërkuara nga KP sipas dispozitivit të vendimit të KPK-së-vitet 2018- 2024


Nga grafiku nr.8, ku shihen krahasimisht kërkimi i ankimeve sipas dispozitivit, në vite nga Komisionerët Publikë, përtej natyrshmërisë ku numri më i madh është konfirmim në detyrë, vihet re se ka edhe: shkarkim nga detyra - 2 vendime/ pushim procesi-2 vendime/pezullim procesi -1 vendim dhe deklarim përfundim procesi pa një vendim përfundimtar-9 vendime, dhe viti 2023 me numrin më të lartë të këtij kërkim ankimi (4 vendime).

Ankime/Mosankime sipas funksionit të s.r.-viti 2024




Grafiku nr. 9 -Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit

ANKIMET SIPAS FUNKSIONEVE TË SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT: 2018-2024




Grafiku nr. 10 – Funkcionet e Subjekteve të rivlerësimit të ankimuar, në vite - 2018-2024

Në grafikun krahasimor për 7 vitet 2018-2024 dhe njëkohësisht përmblendhës, nr. 10, rezulton se numri i prokurorëve (63) është më i lartë se i gjyqtarëve (50) dhe i të tjerëve (11). Vihet re se në vitin 2024, numri i subjekteve të rivlerësimit të ankimuar “Të tjerë” (Këshilltarë/Ndihmës Ligjorë/Inspektorë) është më i larti, 5 (pesë) ankime, krahasuar me vitet e mëparshme: 1/0/1/1/0/3




Denoncimet nga Publiku, Numri i subjekteve të rivlerësimit të denoncuar sipas funksionit, vitet 2018-2024


Ecuria e denoncimeve nga publiku të administruara në IKP gjatë 7 viteve: 2018-2024, është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm nr. 11, ku rezulton se numri më i lartë i denoncimeve të administruara është në vitin 2019, me 361 të tilla, rrjedhimisht edhe numri i subjekteve të denoncuar është i madh, deri në 710 të tillë, shih grafikun nr.11-12.



Grafiku nr. 11 - Denoncimet nga publiku, në vite, 2018-2019-2020-2021-2022-2023-2024



Grafiku nr. 12 – Numri i subjekteve të rivlerësimit të denoncuar nga publiku, në vite, 2018-2024




Grafiku nr. 13 – Numri total i subjekteve të rivlerësimit të denoncuar nga publiku, sipas funksioneve në 7 vite.

1.1.5 - Seancat gjyqësore të zhvilluara në KPA, 2018-2024

Seancat e zhvilluara në vite, ku seanca e parë daton më 16 maj 2018 dhe e fundit më 19 dhjetor 2024, janë në total 389 të tilla. Në grafikun e mëposhtëm, nr.14, tregohet numri i seancave të zhvilluara në vite dhe lidhja e tyre me numrin e subjekteve të shqyrtuara.


Pra, 389 seanca për 84⁴ subjekte rivlerësimi të gjykuar. Mbeten për tu shqyrtuar 41⁵ ankime nga 124 në total.



Grafiku nr. 14 – Numri i seancave të zhvilluara për subjektet e rivlerësimit të gjykuar në KPA, ku kanë marrë pjesë KP, në vite, 2018-2024

⁴ Gjatë vitit 2024 është rigjykuar s.r. A. Sevdari (ankim i vitit 2018, me gjykim të përfunduar më 28.2.2019)

⁵ 41 ankimet do të shqyrtohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, referuar nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës së Shqipërisë “...Pas shpërbërjes së Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese”.




Grafiku nr. 15 – Numri i seancave të zhvilluara për s.r. të gjykuar në KPA, nga Komisionerët Publikë, në total 2018-2024

I.2 - STATISTIKË PËRMBLEDHËSE PËR VITIN 2024

I.2.1 - Vendime të njoftuara nga KPK-ja – viti 2024

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në referencë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2024, është njoftuar për 96 vendime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.


Ecuria e njoftimeve të tyre sipas muajve është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm me nr.16:



Grafiku nr. 16 – Numri i vendimeve të ardhura në IKP, sipas muajve, viti 2024


Sa më sipër, vërehet se muajt prill-korrik-tetor rezultojnë muajt me numrin më të madh të vendimeve të ardhura në IKP (12/12/14) dhe muaji mars dhe gusht me numrin më të vogël të vendimeve (3/0 vendime).

96 vendimet e njoftuara nga KPK, gjatë vitit 2024, kanë dispozitiv:




Vihet re numri i lartë i konfirmimeve në detyrë (63) krahasuar me numrin e proceseve të ndërprera (6) dhe shkarkimeve nga detyra (27), pothuajse në raport 2:1.

Të shprehura në përqindje, të dhënat e dispozitivëve janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm, nr. 17, ku duket qartë vendi që zënë në raport me njëri tjetrin (6%/28%/66%) dhe me tërësinë e dispozitivëve (100%).




Grafiku nr. 17 – Numri i dispozitivëve në përqindje të vendimeve të njoftuara, viti 2024

Në grafikun nr. 18 paraqitet, në mënyrë më të përmblodhur, dispozitivi i vendimeve të ardhura nga KPK-ja, sipas muajve, për vitin 2024.



Grafiku nr. 18 - Dispozitivi i vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK sipas muajve, viti 2024

Subjektet e rivlerësimit, 96 subjekte në total, për të cilët janë njoftuar vendimet nga KPK-ja, janë të funksioneve të ndryshme. Në grafikun e mëposhtëm, nr.19, tregohet numri i tyre: 41-prokurorë /31-gjyqtarë dhe 24-Të tjerë (Këshilltarë Ligjorë/Ndihmës Ligjorë/Inspektorë)




Grafiku nr. 19 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, viti 2024

I.2.2 - Rekomandime nga ONM-ja – viti 2024

Referuar nenit 65/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit B, pika c e aneksit të Kushtetutës, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).

Për vitin 2024, në IKP kanë ardhur 7 rekomandime nga ONM-ja: 1 në prill/1 në maj /1 në korrik/1 në shtator/ 2 në tetor/1 në dhjetor




Grafiku nr. 20 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas muajve, viti 2024

I.2.3 - Shqyrtimi i vendimeve nga Komisionerët Publikë – viti 2024


Për vendimet e njoftuara nga KPK gjatë vitit 2024, pas shqyrtimit të tyre, në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 25 vendime të KPK-së. Për 71 vendime është njoftuar mosankim. Sqarojmë se, sipas afateve ligjore (15 ditë pas njoftimit, referuar nenit 63 të ligjit nr. 84/2016), vendimi i fundit i njoftuar ka qenë më 6.12.2024 dhe ka përfunduar shqyrtimi më 20.12.2024 (Ankim), duke i përmbyllur të gjitha vendimet brenda vitit.

Në grafikun nr.21 tregohet vendimmarrja e Komisionerëve Publikë për 96 vendimet e njoftuara në vitin 2024. (25 –Ankime dhe 71 Mosankime)




Grafiku nr. 21 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, viti 2024

Në grafikun nr.22 janë paraqitur ankimet dhe mosankimet për vitin 2024, sipas muajve të ushtrimit të tyre nga Komisionerët Publikë, ku muaji me numrin më të madh të ankimeve (4), është muaji Korrik 2024 dhe me numrin më të madh të mosankimeve është muaji Tetor 2024.



Grafiku nr. 22 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, viti 2024


Nëse analizojmë statusin e subjektit të rivlerësimit nën këndvështrimin e vendimmarrjes së Komisionerëve Publikë, për vitin 2024, sipas grafikut të mëposhtëm nr. 23, vihet re se numri i gjyqtarëve të ankimuar dhe të mos ankimuar është më i lartë se ai i prokurorëve (12/8), (29/16).



Grafiku nr. 23 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, viti 2024

I.2.4 - Denoncimet nga publiku - viti 2024


Administrimi i denoncimeve nga publiku ushtrohet në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë, në faqen zyrtare të IKP-së, “Formulari i Denoncimit nga Publiku” është vendosur në një menu të veçantë, të dukshme, si dhe në tabelën e Programit të Transparencës.



Grafiku nr. 24 - Denoncimet nga publiku, sipas muajve, viti 2024

Nëse i referohemi grafikut, shihet qartë *trendi* i denoncimeve të ardhura në IKP sipas muajve, ku numri më i madh i denoncimeve është në muajt janar (21) dhe prill (21), dhe më i ulëti në muajt gusht (7) – nëntor (8) denoncime.

Nëse bëjmë një analizë të funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë denoncuar nga publiku, në IKP, për vitin 2024, çka u referua në grafikun e mësipërm, rezulton se denoncimet janë kryesisht për Prokurorë (122) dhe gjyqtarë (63) sikurse pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku nr. 25 - Denoncimet nga publiku, sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, viti 2024

I.2.5 - Pjesëmarrja në seancat e gjykimit të ankimit të IKP-së në KPA - viti 2024


Referuar neneve 5, pika 2, 63, pika 1, 65, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e ankimit të vendimit të KPK-së, nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) e gjykon çështjen në seancë publike.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 67 seanca për 20 subjekte rivlerësimi.

20 subjekte rivlerësimi / 67 seanca gjykimi



Grafiku nr. 26 Seanca të zhvilluara në KPA sipas muajve gjatë vitit 2024



Grafiku nr. 27 – Numri i seancave të zhvilluara për s.r. të gjykuar në KPA, sipas muajve, viti 2024

Në dy grafikët e mësipërm jepen të dhëna mbi numrin e seancave të zhvilluara sipas muajve të vitit 2024, si dhe trendi i tyre, sipas subjekteve të gjykuara.